



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e LjUBLANËS), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1211

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE Interlab SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Mamograf Digjital për Kujdesin Parësor Shëndetësor” me numër të prokurimit 206-25-8054-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, më 02.02.2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e Interlab SH.P.K. me nr. 2025/1211, e datës 08.12.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Mamograf Digjital për Kujdesin Parësor Shëndetësor”, me numër të prokurimit 206-25-8054-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – MINISTRIA E SHËNDETËSISË.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - MINISTRIA E SHËNDETËSISË për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Mamograf Digjital për Kujdesin Parësor Shëndetësor”, me numër të prokurimit 206-25-8054-1-2-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 6, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 04.09.2025 MINISTRIA E SHËNDETËSISË, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Mamograf Digjital për Kujdesin Parësor Shëndetësor” me numër të prokurimit 206-25-8054-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 100.000,00€.

Me 18.11.2025 MINISTERIA E SHËNDETËSISË, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE Konti Sh.P.K.

Me 24.11.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 27.11.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.12.2025, OE Interlab SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1211, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për aktivitetit të prokurimit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Interlab SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

OE ankues parashtron ankesë kundër vendimit për kërkesën për rishqyrtim të publikuar më datë 27.11.2025 në platformën e e-prokurimit. Si palë me interes për këtë procedurë të prokurimit, NUK pajtohem me vlerësimin e pranuar nga AK-ja përmes letrës standarde të tenderuesit të eliminuar, sepse përveç që kemi plotësuar kërkesat e përzgjedhjes, po ashtu edhe ato teknike të detyrueshme, siç kanë qenë të specifikuara në Aneksin 1 të DT-së.

Më 29.09.2025, gjatë hapjes publike të tenderëve (B12), kompania jonë Interlab sh.p.k. rezultonte me ofertën ekonomikisht më të favorshme, duke ofruar pajisje që, sipas vlerësimit tonë profesional dhe dokumentacionit teknik përkatës, i plotësojnë të gjitha specifikimet e kërkuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit (DT). Pavarësisht kësaj, me njoftimin B58 të datës 18.11.2025, AK ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik KONTI sh.p.k., ndërsa oferta jonë është eliminuar me arsyetimin se katalogu i ofruar nuk përmbante të gjitha të dhënat e detajuara për disa parametra teknike.

1. Mosrespektimi i specifikimeve teknike nga OE i rekomanduar për kontratë

Pas pranimit të njoftimit, më 18.11.2025 kemi ushtruar të drejtën tonë për qasje në dosjet e të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, përmes Zyrës së Prokurimit. Nga shqyrtimi i ofertës së OE KONTI sh.p.k. rezulton se në katalogun e dorëzuar, në faqen ku paraqitet modeli Helianthus C i prodhuesit Metaltronica, është nënvizuar si monitor diagnostik Stand-Alone Acquisition Workstation me rezolucion 2 MP. Kjo bie ndesh me kërkesën eksplicite të DT-së, ku është përcaktuar qartë që monitori diagnostik duhet të ketë rezolucion minimal 5 MP.

Duke qenë se rezolucioni i monitorit diagnostik është kriter thelbësor klinik dhe teknik për cilësinë e imazhit dhe diagnostikimin e sigurt, mungesa e përmbushjes së këtij kriteri nga OE i rekomanduar për kontratë e bën ofertën e tij teknikisht të papërgjegjshme dhe, si e tillë, është dashur të refuzohet nga AK në fazën e vlerësimit teknik, në pajtim me Nenin 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) dhe parimin e trajtimit të barabartë.

Po ashtu, nga njoftimi standard për tenderuesit e eliminuar rezulton se edhe OE NPT Medica sh.p.k. është vlerësuar si ofertë që i ka plotësuar kushtet, por nuk është me çmimin më të ulët në mesin e operatorëve të përgjegjshëm. Kjo tregon se AK e ka konsideruar teknikisht të përgjegjshme edhe një ofertë tjetër që ofron sistem të ngjashëm, ndërkohë që nuk është marrë parasysh në mënyrë të barabartë oferta jonë, edhe pse jemi operatori me çmimin më të ulët.

2. Eliminimi i padrejtë i ofertës së Interlab sh.p.k.

Në letrën standarde të eliminimit, AK ka arsyetuar se në katalogun tonë “mungon: rezolucion ≥ 5 lp/mm, mungon: 14–16 bit thellësi, mungon: kapacitet ≥ 3 kW”. Theksojmë se sistemi mamografik i ofruar nga ne, PLANMED Clarity S i prodhuesit finlandez PLANMED OY, i përmbush plotësisht këto kërkesa teknike. Këtë mund ta dëshmojmë me dokumentacionin zyrtar teknik të prodhuesit, i cili është paraekzistues dhe i verifikueshëm.

Edhe nëse AK ka vlerësuar se në katalogun e bashkëngjitur nuk janë paraqitur në mënyrë eksplicite të gjitha të dhënat, ka pasur detyrimin ligjor që, në pajtim me:

Nenin 72 të LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, si dhe

Nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik – Sqarimi i Tenderëve,

të kërkojë sqarime dhe/ose dokumente shtesë nga ne, për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike. Mosshfrytëzimi i kësaj mundësie ka rezultuar në eliminim disproporcional të ofertës sonë, duke cenuar parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe konkurrencës së drejtë.

3. Çështja e sistemit të integruar apo të ndarë dhe kriteret jo të specifikuar

Në DT nuk është përcaktuar askund se monitori diagnostik duhet të jetë i integruar apo i ndarë, ndërsa oferta jonë ka përmbushur specifikimet teknike të DT-së. Nga ana tjetër, OE KONTI sh.p.k., si dhe NPT Medica sh.p.k., sipas katalogëve të ofertuar, kanë paraqitur sisteme me monitor të ndarë dhe jo të integruar. Prandaj, çdo dallim i pretenduar në këtë drejtim nuk mund të përdoret si bazë për eliminimin e ofertës sonë, sidomos në mungesë të specifikimit të qartë në DT.

Oferta e KONTI sh.p.k. – vërehet qartazi që në faqet 4, 9 dhe 10 të katalogut që është ofruar sistem i ndarë.

Oferta e NPT Medica sh.p.k.

Sa i përket printerit, DT nuk ka pasur kërkesa të detajuara teknike. Ne kemi përfshirë printer në ofertën tonë dhe kemi dorëzuar edhe deklaratë të nënshkruar dhe të vulosur se printeri është i përfshirë në furnizim. Edhe për këtë element, AK ka pasur mundësinë ligjore që, përmes Nenit 72 të LPP-së dhe Nenit 38 të Rregullores nr. 001/2022, të kërkojë sqarime shtesë, në vend se të

konkludojë në mënyrë automatike për paplotshmëri.

5. Kërkesa jonë konkrete

Referuar neneve 1, 6 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik, theksojmë se oferta jonë është oferta më e ulët në çmim krahasuar me të gjithë operatorët ekonomikë të tjerë, çka do të thotë se, në rast të shpalljes sonë si fituese, do të arrihej vlera më e mirë për paranë publike (“value for money”). Mosshpallja jonë si fituese, pavarësisht këtij fakti, cenon parimin e ekonomicitetit dhe të vlerës më të mirë për paranë publike të parashikuar në LPP.

Në bazë të kësaj, vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrimin ligjor që, para se të na eliminojë, në fazën e vlerësimit/rivlerësimit, të kërkonte sqarime shtesë për të gjitha pikat e pretenduara si arsye eliminimi, në mënyrë që të sigurohej një vlerësim i drejtë, objektiv dhe në përputhje me parimet e transparencës dhe efikasitetit të shpenzimeve publike. Mospasja e një procedure të tillë sqarimi para eliminimit përbën shkelje të parimeve themelore të LPP-së.

Për këto arsye, i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) që, në ushtrim të kompetencave të tij ligjore, të konstatojë parregullsitë në veprimet e Autoritetit Kontraktues dhe të urdhërojë kthimin e lëndës në rivlerësim, duke përcaktuar për AK-në obligimin që, në këtë fazë, të kërkojë sqarimet e nevojshme nga OE “Interlab”, për të gjitha pikat e eliminimit, në mënyrë që të sigurohet një rivlerësim i drejtë, objektiv dhe në pajtim me nenet e lartpërmendura të LPP-së.

Në këtë kuadër, nga OSHP kërkojmë që:

Të shfuqizojë vendimin e Autoritetit Kontraktues të pasqyruar në njoftimin B58 të datës 18.11.2025;

Të kthejë lëndën tek Autoriteti Kontraktues për rivlerësim të plotë, duke e urdhëruar AK-në që të marrë parasysh të gjithë dokumentacionin paraekzistues, i cili dëshmon se oferta jonë i përmbush të gjitha kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit (DT);

Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues për rivlerësimin e përgjegjshmërisë teknike të ofertës së OE “KONTI” sh.p.k., në veçanti sa i përket mospërmbushjes së kërkesës për monitor diagnostik minimal 5 MP;

Të konstatojë se oferta jonë është ofertë e përgjegjshme dhe ekonomikisht më e favorshme, në përputhje me parimet e LPP-së, dhe në përputhje me këtë të orientojë AK-në në vendimmarrje;

Nëse konstatohet se është shkaktuar dëm për OE “Interlab” sh.p.k. për shkak të moszbatimit korrekt të LPP-së nga ana e AK-së, të njihet e drejta jonë për kompensim të dëmit material, sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konsiderojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara, meqenëse ju nuk keni ofruar asnjë sqarim apo dëshmi për të kundërshtuar njoftimin për eliminimin e ofertës tuaj dhe arsyet e eliminimit të përshkuara në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 18.11.2025.

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye, pasi nuk i keni ofruar një pjesë të specifikave në katalog:

- Mungon: rezolucion ≥ 5 lp/mm
- Mungon: 14–16 bit thellësi
- Mungon: kapacitet > 3 kW
- Monitori diagnostik është ofruar i ndarë nga mamografi

Nuk e keni ofruar printerin për filma të mamografisë. Me sqarimet shtesë të publikuara me datën 16.09.2025 është sqaruar se printeri duhet të përfshihet në kuadër të aksesorëve. Në DT, në Aneksin 1, është përshkruar printeri si opsional, ndërsa pas këtyre sqarimeve nuk është më opsional, por kërkohet si aksesor i mamografit.

Pretendimet tuaja teknike për ofertën e rekomanduar për kontratë janë shqyrtuar nga ekspertët bioinxhinierë në kuadër të AK-MSh, të cilët kanë dhënë sqarimet teknike si në vijim:

Në katalogun e OE të rekomanduar është specifikuar: “It is possible to supply the display monitor with a resolution of 2, 3, or 5 MP.” (Përkthim: “Është e mundur të furnizohet monitori me rezolucion prej 2, 3 dhe 5 MP.”)

OE i rekomanduar e ka ofruar monitorin e vendit punues (Workstation) me rezolucion 5 MP, siç është kërkuar, siç shihet më poshtë në dëshmitë nga katalogu. Specifika e selektuar në faqen 10 të katalogut të OE të rekomanduar KONTI.

Në bazë të sqarimeve të lartcekura, si AK-MSh konsiderojmë se kemi vepruar drejt, duke mos diskriminuar apo favorizuar ndonjë OE, por duke e përzgjedhur ofertën e përgjegjshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 12.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1211, ndërsa me datë 29.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1211, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, në analizën e dokumentacionit relevant dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, eksperti teknik vlerëson se ankesa e paraqitur nga Operatori Ekonomik Ankues është e pabazuar.

Për rrjedhojë, i propozohet Panelit Shqyrtues që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të lihet në fuqi njoftimi për kontratë i Autoritetit Kontraktues, duke vazhduar procedurën e prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEInterlab SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1211 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje nga Eksperti Teknik në pretendimet e OE Ankues

OE Ankues ka paraqitur pretendimin se OE Fitues nuk e posedon këtë lloj monitori. Megjithatë, në dokumentacionin e prodhuesit shihet qartë se ky monitor ekziston tek prodhuesi përkatës dhe se vetë selektimi i monitorit me ngjyra përfaqëson zgjedhjen e duhur në 5 MP.

Sa i përket OE Ankues, prodhuesi Planmed nuk posedon monitor 5 MP. Vlen të theksohet se, në listën e pjesëve rezervë për pajisje, edhe pse OE ka ofruar monitor jashtë prodhuesit Planmed, ky monitor ose pjesë rezervë nuk është e cekur në listën e pjesëve rezervë për JUSHA, por vetëm për Planmed, gjë që është pjesë obligative e Dosjes së Tenderit.

Sa i përket sistemit Clarity S, OE Ankues ka deklaruar se i plotëson specifikat. Megjithatë, ky sistem apo ky prodhues nuk i plotëson kushtet bazike. Vetë në listën e pjesëve rezervë është e cekur se disa pjesë nuk mund të zëvendësohen me pjesë të reja, por vetëm me pjesë të rifabrikuara (refurbished). Kjo automatikisht e eliminon këtë sistem nga tenderët publikë, pasi që në rast defektesh, pjesët e ndërruara nuk duhet të jenë të rifabrikuara ose të përdorura, por duhet të jenë të reja.

Më poshtë është paraqitur fakti mbi të cilin mbështetet konstatimi se ky produkt nuk është i përshtatshëm për Ministrinë e Shëndetësisë apo për prokurimet publike në Kosovë.

Pikat 3 dhe 4 janë të pakuptimta, pasi më shumë paraqesin një vlerësim dhe krahasim të dy ofertave sesa një ankesë të mirëfilltë lidhur me pikat që OE i ka përfshirë në vendimin e njoftimit për kontratë.

Sa i përket deklaratës së OE se do të sjellë monitor diagnostik dhe printer, në dosjen e OE Ankues nuk është gjetur në asnjë vend specifikimi se çfarë lloj printeri është ofruar. Vlen të theksohet se printerët për mamografi duhet të jenë të kualitetit të lartë mjekësor dhe nuk janë printerë të zakonshëm për letra. Për këtë arsye, konsiderohet se edhe kjo pikë është e arsyeshme dhe e drejtë nga ana e AK-së.

Rekomandim i Ekspertit Teknik

Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga Operatori Ekonomik Ankues dhe pas analizës së dokumentacionit teknik, manualeve të prodhuesit, si dhe përgjigjeve sqaruese të Autoritetit Kontraktues, eksperti teknik vlerëson se të gjitha pretendimet e OE Ankues janë të pabazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit,

konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues profesional dhe teknik mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues profesional dhe teknik, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. përveç pretendimit lidhur me sistemin Clarity S, të cilin paneli shqyrtues e kualifikon si pjesërisht të bazuar, por megjithatë edhe eksperti teknik por edhe AK kanë deklaruar se ky sistem nuk është i mjaftueshëm dhe nuk është komplet konform specifikave. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues dhe teknik

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar por e pamjaftueshme për të ndryshuar epilogun përfundimtar të kësaj lënde. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues MINISTRIA E SHËNDETËSISË, lidhur me aktivitetin e “Furnizim me Mamograf Digjital për Kujdesin Parësor Shëndetësor” me numër të prokurimit 206-25-8054-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Interlab SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: